

IMPAKTI SOCIAL DHE POLITIK I GREVAVE TË MINATORËVE TË
TREPÇËS GJATË SHEKULLIT XX

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I SHKENCËS NË HISTORI E KOHËS SË RE

NGA

GAZMEND RAMA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
Departamenti i Historisë
PRISHTINË

Mars, 2023

REZYME E TEMËS

**IMPAKTI SOCIAL DHE POLITIK I GREVAVE TË MINATORËVE TË
TREPÇËS GJATË SHEKULLIT XX**

Mentor:

Prof.Dr. Gazmend RIZAJ

Kandidati:

Gazmend RAMA

Miniera e Trepçës u shfrytëzua që nga kohët më të lashta, romakët gërmuan xehet dhe i shfrytëzuan deri në ardhjen e sllavëve në mesjetë. Trepça u bë qendër e rëndësishme xehetare dhe tregtare në të cilin jetonin e punonin shqiptarë, serbë, sasë, dubrovnikas etj. Me pushtimin e Osmanëve në Ballkan në fundin e periudhës mesjetare zhvillimi i minierës së Trepçës u ndërpre dhe e humbi rëndësinë e vet që kishte. Gjatë tërë kësaj kohe me ndërrimin e pushtuesve nuk pati punime dhe nxjerrje të xeheve. Pas Luftës së Parë Botërore kapitalistët anglezë u interesuan për minierën e Trepçës. Në fillim të viteve të 20'ta të shek. XX anglezët filluan hulumtimet e para. Ndërkaq eksploatimi i Trepçës filloi në vitet e 30'ta të atij shekulli, periudhë kjo që u përcoll me lëvizje sindikale dhe greva si në ndërmjet Dy Luftërave Botërore ashtu edhe pas Luftës së Dytë Botërore.

Kapitulli i parë fillon me historikun e Trepçës ndër shekuj prej fillimit të shfrytëzimit të saj. Po ashtu në këtë kapitull do të flasim edhe për qytetin e Mitrovicës, industrinë dhe rëndësinë e saj që kishte në periudhat historike. Po ashtu do të flasim edhe për Trepçën nën udhëheqjen britanike si dhe për lëvizjen e sindikatave në mes të dy luftërave Botërore.

Në kapitullin e dytë do të flasim për fundin e fazës britanike dhe shfrytëzimin e Trepçës nga gjermanët gjatë Luftës së Dytë Botërore. Po ashtu do të flasim për fundin e luftës së dytë Botërore dhe marrjen e Trepçës nga Jugosllavia dhe shfrytëzimin e saj.

Në kapitullin e tretë do të flasim për minatorët, organizimet e grevave, situatën politike në atë periudhë dhe rëndësinë e grevave në ndërkombëtarizimin e problemit të Kosovës. Fokusi kryesor në këtë kapitull është në organizimin dhe grevën historike të minatorëve në shkurt të vitit 1989 që zgjati 8 ditë.

Greva e minatorëve të Trepçës pati karakter politik dhe social të cilët dolën në mbrojtje të Kushtetutës së Kosovës. Minatorët ishin të vendosur që t'i mbronin të drejtat e tyre dhe të qëndronin në grevë deri në realizimin e kërkesave të tyre.

Greva e minatorëve të Trepçës pati ndikim të madh në ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës, po ashtu tundi themelet e shtetit jugosllav si dhe nxori në pahë pikëpamjet politike të kastës politike serbe ndaj popullit shqiptar në Kosovë. Greva e minatorëve të Trepçës në Stantërg kishte rëndësi të madhe për vet fatkin se pati një impakt të madh në proceset e mëvonshme politike deri në shembjen e regjimit komunist në Jugosllavi, që determinuan krijimin e shtetit të pavarur të Kosovës.